



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 60, datë 23.12.2020

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE TË LEJUAR
PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT TË KRIJUAR NË GJYKATËN
KUSHTETUESE, VAKANCË E PARAKOHSHME, E SHPALLUR NGA
PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 07.02.2018, RISHPALLUR NË DATËN
27.09.2019 DHE RISHPALLUR NË DATËN 24.09.2020**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të pikës 5 të nenit 229 dhe nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si edhe të pikave 71 e 72 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi "Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi përfundoi vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit të lejuar për këtë vend vakant, si dhe miratoi listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.



ZËVENDËSKRYETARE

Vitore TUSHA